NP KOMUNALEC
Nr. 02-8800/7
08.10.1992
Shkup

Në bazë të nenit 187-a të Ligjit për ndërmarrje dhe nenit 23 të Statutit të NKP Komunalec, Këshilli i Punëtorëve i NKP Komunalec në mbledhjen e mbajtur më datë 08.10.1992 e miratoi vendimin në vijim

VENDIM

për ndarjen e Ndërmarrjes në më shumë ndërmarrje
të veçanta publike

Neni 1

Me këtë Vendim NKP Komunalec – Shkup ndahet në më shumë ndërmarrje të veçanta publike për kryerjen e veprimtarive komunale sidomos:

1. Ndërmarrja Publike "Ujësjellës dhe Kanalizime"
2. Ndërmarrja Publike "Higjiena Komunale"
3. Ndërmarrja Publike "Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Arterieve"
4. Ndërmarrja Publike "Mirëmbajtja e Parqeve dhe Gjelbërimeve"
5. Ndërmarrja Shoqërore "Florakom".

Ndarja e NKP Komunalec në ndërmarrje të veçanta publike bëhet sipas principit të ndarjes së pjesëve aktuale të ndërmarrjes publike të organizuara në ndërmarrje të veçanta publike.

Neni 2

Marrja përsipër e mjeteve dhe të drejtave të NKP Komunalec nga ana e ndërmarrjeve të reja që themelohen me këtë Vendim do të bëhet në bazë të marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet ndërmarrjeve publike.

Neni 3

Ndërmarrjet e veçanta publike që themelohen me ndryshimet e statusit me këtë Vendim do të marrin përsipër përgjegjësi të pakufizuar solide për obligimet e NKP Komunalec e cila pushon së ekzistuari pas ndarjes së bërë me bilancin e ndarjes.

Bilanci i ndarjes i NKP Komunalec i ndërmarrjeve të sapoformuara publike do të bëhet sipas kritereve që do të miratohen nga Komisioni i veçantë i formuar me zgjedhjen e anëtarëve nga secila ndërmarrje e ndarë publike (nga një anëtar) dhe Drejtori i përgjithshëm i NKP Komunalec.

Neni 4

Marrja e punëtorëve në NKP Komunalec nga ndërmarrjet e reja publike do të bëhet sipas kritereve të përkatësisë së çdo të punësuari nga pjesët e ndërmarrjes që ndahen në ndërmarrje të reja.

Të punësuarit në Bashkësinë e punës të NKP Komunalec do të merren sipas kritereve të angazhimit të tyre të punës për pjesët e veçanta të ndërmarrjes si dhe pjesëmarrjes aktuale në financimin e Bashkësisë së punës nga organizatat ekzistuese.

Me marrëveshje të veçantë që do të lidhet ndërmjet ndërmarrjeve të sapothemeluara publike do të përcaktohet numri i të punësuarve që merren nga çdo ndërmarrje e sapothemeluar publike.

Neni 5

Me nenin 5 përcaktohet emri i firmës dhe selia e ndërmarrjeve të sapothemeluara publike:

1. Ndërmarrja Publike "Ujësjellës dhe Kanalizim" me përgjegjësi të plotë. Emri i shkurtuar i firmës është "Ujësjellës dhe Kanalizim". Selia e ndërmarrjes "Ujësjellës dhe Kanalizim" është në Shkup, rr. Llazar Liçenovski, nr.27.
2. Ndërmarrja Publike "Higjiena Komunale" me përgjegjësi të plotë. Emri i shkurtuar i firmës është "Higjiena Komunale". Selia e ndërmarrjes "Higjiena Komunale" është në Shkup, rr. 126, nr.40.
3. Ndërmarrja Publike "Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Arterieve" me përgjegjësi të plotë. Emri i shkurtuar i firmës është "Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Arterieve". Selia e ndërmarrjes "Mirëmbajtja e Rrugëve dhe Arterieve" është në Shkup, rr. Kole Nedellkovski" nr.38.
4. Ndërmarrja Publike "Mirëmbajtja e Parqeve dhe Gjelbërimeve" me përgjegjësi të plotë. Emri i shkurtuar i firmës është "Mirëmbajtja e Parqeve dhe Gjelbërimeve". Selia e ndërmarrjes "Mirëmbajtja e Parqeve dhe Gjelbërimeve" është në Shkup, rr. Ilindenska" PP.
5. Ndërmarrja Shoqërore "Florakom". Selia e ndërmarrjes "Florakom" është në Shkup.

Neni 6

1. Ndërmarrja Publike "Ujësjellës dhe Kanalizim" i kryen veprimtaritë në vijim:
   100310 – Prodhim dhe shpërndarje të ujit (mbledhje, pastrim dhe shpërndarje të ujit amvisërive, konsumatorëve industrialë dhe konsumatorëve tjerë;
   100310 – Filtrim dhe shkarkim të ujërave të zeza (filtrim të ujërave të zeza dhe rrjetit të kanalizimit me të cilin shkarkohen ujëra të zeza nga amvisëritë, stabilimentet industriale dhe stabilimentet tjera dhe ujërat atmosferike.
   - Mbikëqyrje të cilësisë – dezinfektim të rrjetit të kanalizimit, analizë të rregullt bakteriologjike dhe kimike të ujit të pijshëm, kryerje të kontrollit të ujit cilësor;
   - Mirëmbajtje dhe shfrytëzim të mjeteve motorike dhe makinave të ndërtimit;
   - Mirëmbajtje të objekteve.

2. Ndërmarra Publike "Higjiena Komunale" i kryen veprimtaritë në vijim:
   100351 – Pastrim të sipërfaqeve publike në lagje;
   100351 – Sjellje, deponim dhe ripërpunim të mbeturinave;

1003391 -Shërbime të pastrimit të oxhaqeve
- Mirëmbajtje dhe shfrytëzim të mjeteve motorike dhe makinave të ndërtimit.

3. Ndërmarrja Publike "Mirëmbajtja e rrugëve dhe arterieve" i kryen veprimtaritë në vijim:
   100102 - Rregullim dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe arterieve;
   - Mirëmbajtje dhe shfrytëzim të mjeteve motorike dhe makinave të ndërtimit;
   - Ndërtimi i objekteve të trafikut, rikonstruktimi dhe meremetimi i rrugëve urbane dhe interurbane dhe shesheve;

   050202 - Ndërtimi i objekteve hidrondërtimore.

4. Ndërmarrja Publike "Mirëmbajtja e Parqeve dhe Gjelbërimeve" i kryen aktivitetet në vijim:
   100103 - Rregullimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe sipërfaqeve për rekreacion (rregullim dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelbra publike, park pyjeve, parqeve, aleve të drurëve, lëndinave, gjelbërimit rreth arterieve, sipërfaqeve të gjelbra të bashkësive banesore, sipërfaqeve për rekreacion dhe fushave të fizkulturës, vendeve për piknik, terrene të fizkulturës etj);
   - Shtrimi i gjelbërimit dhe dekorimi;
   - Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi mjeteve motorike dhe makinave të ndërtimit dhe makinave tjera.

5. Ndërmarrja shoqërore "Florakom" i kryen aktivitetet në vijim:
   020100 - Bujqësia, prodhimi i luleve dhe bimëve dekoruese;
   070126 - Tregtia me pakicë- qeramikë, qelq dhe porcelan;
   070132 - Tregti me pakicë - tregti tjetër me mall të përzier.

Neni 7

Ndërmarrja Publike "Ujësjellës dhe Kanalizim" obligohet që edhe në të ardhmen nga çmimi për 1m3 ujë t'i ndajë mjete në shumë prej 22% Ndërmarrjes Publike "Parqe dhe Gjelbërime" për mirëmbajtje të gjelbërimit publik në Qytetin, derisa Kuvendi i Qytetit të gjejë mënyrë adekuate për financimin e kësaj veprimtarie:

Neni 8

Me regjistrimin e ndërmarrjeve të reja publike në regjistrin gjyqësor pushon së ekzistuari NKP "Komunalec" dhe e njëjta do të fshihet nga regjistri gjyqësor.

Neni 9

Mbledhjet e punëtorëve të ndërmarrjeve të sapothemeluara publike me vendim të tyre do të emërojnë ushtrues detyre Drejtorë që do t'i ndërmarrin të gjitha aktivitetet për regjistrimin e ndërmarrjeve të sapothemeluara publike.

KRYETAR I KËSHILLIT TË PUNËTORËVE,
SHKUP
Borevski Nikolla